# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr. Rendo r [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundi mit të kërkesës[6] | Tari fa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 02/02/2022 | Info per certifikim<br>Pershendetje,<br>Uroj te jeni mire,<br>Lutem nese mund te siguroj nje informacion per aplikim dhe testimin e radhes per te marre certifikimin si Perfaqesues i Autorizuar i Pronesise Industriale.<br>Ju falenderoj | 03/02/2022 | Pershendetje,<br><br>Uroj te jeni mire.<br>Ne lidhje me pyetjen tuaj, ju bejme me dije se provimi per Perfaqesues i Autorizuar do te zhvillohet ne muajin Mars.<br>Te gjithe aplikantet qe kane dorezuar dokumentacionin e sakte prane DPPI, per pjesemarrje ne provim, do te njoftohen sapo te caktohet data.<br>Dokumentat qe duhet te dorezohen per pjesemarrje ne provimin e licenses si PA jane:<br>Diplomat e noterizuara<br>Certifikatat e trajnimeve qe keni marre ne fushen e Pronesise Industriale.<br>CV<br>Kerkesen per pjesemarrje ne provim.<br>Mandat pagesen per pjesemarrje ne provim prej 5000 lekesh.<br><br>Per cdo informacion te metejshem, mbetemi ne kontakt.<br><br>Ju uroj dite te mbare, | E-mail<br>Perfunduar | 0 |
| 2 | 10/02/2022 | Pershednetje,<br>Doja te dija cfare dokumentash duhet te paraqes prane insistucionit tuaj per tu regjistruar si perfaqesuese e autorizuar per markat tregtare? Aktualisht | 11/02/2022 | Pershendetje,<br><br>Atehere shikoni ne faqen zyrtare http://dppi.gov.al/legjislacionikomb/ kete vendim te Keshillit te Ministrave:<br><br>VENDIM NR. 317, DATË 31.5.2018 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR NË | E-mail<br>Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | disponoj certificate bachelor dhe master ne juridik, licence avokatie, dhe ushtroj profesionin si avokatie, dhe ushtroj profesionin si avokate ne nje zyre avokatie ne Tirane prej 3 vitesh.<br>Ne pritje te pergjigjes tuaj,<br>Faleminderit paraprakisht. | | DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE”<br>Tarifa fillestare eshte 5000 lek te reja.<br><br>Me tej, pas kualifikimit dhe daljes fitues, tarifa per terheqjen e Licences eshte 10000 leke te reja.<br><br>Me tej, pas kualifikimit dhe daljes fitues, tarifa per heqjen e Licences eshte 10000 leke te reja.<br>Faleminderit! | | |
| 3 | 18/02/2022 | Informacion per patentat<br>Pershendetje,<br><br>Ju lutem, mund te me jepni nje orientim te pergjithshem se cfare procedure ndiqet per te patentuar nje model perdorimi. Konkretisht, nje klienti yne qe eshte paruker ka shpikur nje teknike te re per lyerje flokesh. Dhe kete teknike do ta patentoj, qe me pas te kete mundesi te trajtnoj kursante | 24/02/2022 | Pershendetje,<br>Bashkengjitur gjrni ju lutem nje material sqarues mbi procedurat per te cilat jeni te interesuar, formularin e aplikimit si dhe faturen per arketim me te dhenat bankare te DPPI, e cila dorezohet per tu paguar vetem ne BKT.<br>Ju gjithashtu, ne rast nevoje ose paqartesi, mund te kerkoni ndihmen e nje prej perfaqesuesve te autorizuar, te licencuar nga DPPI, te cilet jane profesioniste te lire, specialist te fushes. Listen e perfaqesuesve te autorizuar e gjeni ne regjistrin e perfaqesuesve te autorizuar, ne faqen tone web, ne linkun:<br>http://regjistriperfaqesuesvetepi. | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | per kete qellim.<br><br>Duke ju falenderuar paraprakisht,<br><br>Me respekt, | | dppi.gov.al/index.html<br><br>Faleminderit per bashkepunimin, | | |
| 4 | 21/02/2022 | Mbrojtje marke<br><br>Pershendetje,<br>Une doja te beja mbrojtjen e nja marke te huaj per te cilen kam te drejten eksluzive mbi ate produkt per ne Shqiperi. ju lutem si duhet te veproj per mbrojtjen e markes duhet e depozitoj kontrate e ekskluzivitetit apo thjesht te plotesoj formularine depozitimit per mbrojtjene markes? Ne pritje te pergjigjes tuaj sa me shpejt ju lutem.<br><br>Faleminderit | 25/02/2022 | Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të emailit tuaj ju informoj se marka është objekt i Pronësisë Industriale dhe si e tillë mund të regjistrohet në Republikën e Shqipërisë vetëm nga pronari i saj, i cili sikurse ju na informoni në emailin tuaj, është një subjekt i huaj me të cilin ju keni marrëdhënie bashëkëpunimi në lidhje me distribucionin e mallrave të markës në fjalë.<br><br>Në këto kushte, nëse marka është ende e paregjistruar, hapi i parë për t'u ndjekur është të aplikohet për regjistrimin e saj nga mbajtësi i së drejtës me një kërkesë, që mund të depozitohet në DPPI vetëm nëpërmjet një përfqësuesi të autorizuar, të licencuar nga DPPI listën e të cilëve e gjeni ne linkun: http://regjistriperfaqesuesvetepi.dppi.gov.al/index.html | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Pronari i markës mund të aplikojë për regjistrimin e markës në Republikën e Shqipërisë edhe me aplikim ndërkombëtar në zyrën e WIPO.<br><br>Në vijim të regjistrimit të markës, aplikohet për regjistrimin e licencimit të të drejtave mbi markën në territorin shqiptar, të cilat iu akordohen personave të tretë (që në rastin konkret jeni ju), nga pronari i markës me kontratë të nënshkruar nga të dyja palët, përpara noterit.<br><br>Pra, si përfundim:<br>Mbi markën e dikujt tjetër, ju nuk mund të bëheni pronar i markës, por mund të kërkoni të regjistroni kontratën e licencës së përdorimit të markës në territorin shqiptar ne bazë të nenit 63 të Ligjit nr. 9947, dt. 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, dhe neneve 33 e 34 te VKM nr.315, dt. 31.05.2018 “Për miratimin e rregullores së markave”.<br><br>*Neni 63 i ligjit: Marka mund të licencohet për disa ose për të gjitha mallrat apo shërbimet, për të cilat ajo është regjistruar. Licenca* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *mund të jetë ekskluzive ose joekskluzive.*<br>*Kontrata e licencës bëhet me shkrim, nënshkruhet nga të dyja palët dhe depozitohet në DPPI.*<br>*Pronari i markës së licencuar mund të përdorë të drejtat, që rrjedhin nga regjistrimi i markës, kundër të licencuarit që shkel kushtet e përcaktuara në kontratë, për kohëzgjatjen e saj, formën sipas së cilës duhet të përdoret marka, klasat e mallrave ose të shërbimeve, për të cilat është lëshuar licenca, territorin ku përdoret marka, ose për cilësinë e produkteve të prodhuara apo të shërbimeve që sigurohen nga i licencuari.*<br>*Kontrata e licencës nuk është e vlefshme, nëse nuk përmban detyrimet që licencuesi i vendos të licencuarit për zbatimin e kushteve të përcaktuara në kontratë, sipas pikës 3 të këtij neni.*<br>*Kontrata e licencës nuk ka asnjë efekt ligjor, nëse nuk është e regjistruar në regjistrin e markave të DPPI-së. I licencuari ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë dhe të kryejë çdo veprim tjetër, të njohur me ligj, kundër shkeljes së të drejtave për markën vetëm me pëlqimin e licencuesit,* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *përveç kur në kontratën e licencës është parashikuar ndryshe. Kur licenca është ekskluzive, i licencuari ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë dhe të kryejë çdo veprim tjetër, të njohur me ligj, kundër shkeljes së të drejtave për markën edhe pa pëlqimin e licencuesit, nëse ai, edhe pse është njoftuar nga i licencuari, nu*k kryen asnjë veprim *të njohur me ligj për mbrojtjen e markës, brenda një periudhe kohe të arsyeshme. I licencuari ka të drejtë të ndërhyjë në një padi të ngritur nga licencuesi kundër shkeljes së të drejtave për markën, kur kjo ndërhyrje ka për qëllim shpërblimin e dëmit të pësuar prej tij nga shkelja e të drejtave. DPPI-ja refuzon regjistrimin e një kontrate licence në regjistër, nëse nuk paraqitet dokumentacioni përkatës në kohën e caktuar. Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e kontratës së licencës parashikohen në rregulloren përkatëse, dalë në zbatim të këtij ligji.* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Faleminderit për bashkëpunimin. | | |
| 5 | 08/03/2022 | Kerkese-ankese (ISHMT)<br><br>Përshëndetje,<br><br>Pranë ISHMT, ka mbërritur Kërkesë-Ankesë në lidhje me cënimin e markës tregtare të regjistruar VOTRA , me nr regj. 17822 pranë DPPI. Kërkesë-Ankesa ka të bëjë me markën tregtare Vatra e cila përdoret në treg nga një subjekt tregtar i cili operon në të njëjtën fushë. Markat në fjalë nuk janë identike, ndaj për këtë arsye na nevojiten shpjegime profesionale mbi keqorientimin që sjell në treg marka ndaj së cilës është bërë ankesa për shkak të ngjashmërisë. Referuar Ligj nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" dhe Vendim nr. 501, datë 29.08.2018 Ju lutem na vini në dispozicion listën e | 09/03/2022 | Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju bëj me dije se DPPI-ja shprehet nëse ka apo jo cënim të një të drejte të mëparshme të pronësisë industriale në kuptim të nenit 143, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar (ligji) me vendim, në bazë të neneve 152 e vijuese të ligjit, **vetëm nëse ka marrë një kërkese drejtuar dhomës për shqyrtimin e kundërshtimeve pranë DPPI-së, nga një palë e interesuar, për kundërshtimin e një marke të aplikuar për regjistrim, si dhe bazuar në nenin 173 të ligjit, shprehet me vendim në vijim të një kërkese të për shfuqizimin e një marke të regjistruar, drejtuar dhomës për shfuqizim/zhvlerësim, pranë DPPI-së, nga një palë e interesuar.**<br><br>Ju informoj gjithshtu, se nuk ka asnjë ekspert të PI të regjistruar në regjistrin e ekspertëve të PI. | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ekspertëve të regjistruar pranë DPPI për një mendim më të specializuar në lidhje me këtë çështje.<br><br>Faleminderit, | | Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, | | |
| 6 | 29/03/2022 | Kerkese per informacion<br><br>Pershendetje ,<br><br>Ju drejtohem , per proceduren e markimit te nje emri tregetar.<br><br>Eshte biznes jashte Shqiperie , rrjet sherbimi ne vende te ndryshme te botes, dhe kerkon te rregjistroje marken dhe ne Shqiperi .<br><br>**Duhet patjeter te hape biznes me Nipt ne Shqiperi ?.**<br><br>**Ju lutem me ndihmoni , cfare hapash duhet te ndermarre per te rregjistruar marken ne Shqiperi.** | 04/04/2022 | Ne pergjigje te e-mailit tuaj, ju bej me dije se marka mund te regjistrohet nga çdo person, qoftë individ (me kusht që të ketë zotesi te plote per te vepruar), qoftë subjekt tregtar shqiptar ose i huaj. Ne ne baze te nenit 195, te ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale (PI)" i ndryshuar, personat e huaj mund te aplikojne ne Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), vetem nepermjet nje (ose disa) prej perfaqesuesve te autorizuar të PI, të licencuar ne DPPI, të cilët janë profesionistë të lirë, specialistë të fushes se PI-së. Listën e përfaqësuesve të autorizuar e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Duke ju falenderuar ne avance ,<br>ju uroj pune te mbare. | | Bashkëngjitur gjeni ju lutem një material sqarues mbi procedurat për të cilat jeni të interesuar, si dhe faturën për arketim më të dhënat bankare të DPPI, e cila dorëzohet për t'u paguar vetëm në BKT.<br><br>Ju gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar sikurse ju informuam me siper.<br><br>Faleminderit per bashkepunimin. | | |
| 7 | 04/05/2022 | Kerkese-ankese (ISHMT)<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në vijim, të shqyrtimit të kërkesë-ankesës së mbërritur pranë ISHMT nga Agencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit në lidhje me perdorimin ne mënyrë të pa autorizuar të markës tregtare e-Albania dhe bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit midis DPPI-së dhe ISHMT-së, kërkojmë informacion ne lidhje me statusin e | 05/05/2022 | Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion në lidhje me markën me numër regjstrimi kombëtar **19564**, ju informojmë se marka me të dhënat si në vijim:<br><br>Numër aplikimi AL/T/2018/46<br><br>Me emërtimin "e-albania" dhe pamje: | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | markës tregtare me numër regjistrimi 19564 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.<br><br>Për sa më sipër, lutemi dërgimin e informacionit brenda datës 05/05/2022!<br><br>Duke iu falenderuar për mirëkuptimin, | | Me listë mallrash dhe/ose shërbimesh sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Nicës:<br><br>Klasa 9: Publikime elektronike të shkarkueshme;Programe që venë në veprim kompjuterat, të regjistruara;Software (kompjuteri), të regjstruara<br>Klasa 35: Përpilim informacioni në sisteme të dhënash kompjuterike;Sistemi i informacionit në sistemet e të dhënave kompjuterike<br>Klasa 36: Sigurimet;çështjet financiare;çështjet monetare;çështjet e pasurive të patundshme<br>Klasa 38: Komunikime me anë të fibrave të rrjeteve optike;Sigurim aksesi në database;Transmetim skedaresh dixhitale;Transmetim i mesazheve dhe imazheve (Me ndihmen e kompjuterit)<br>Klasa 42: Sherbimet shkencore dhe teknologjike si dhe kerkime dhe dizajne në lidhje me këto shërbime;shërbime të analizave industriale dhe kërkimeve;dizajni dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | zhvillimi i pajisjeve kompjuterike dhe software.<br><br>Me pronar: AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit);<br><br>Me adresë: Rr."Papa Gjon Pali II", nr.3, kati I, Tiranë;<br><br>Depozituar më datë: 18/01/2018;<br><br>Me numër regjistrimi kombëtar: 19564;<br><br>Nga baza elektronike e të dhënave që DPPI disponon, rezulton "**e regjistruar**" për një periudhë 10 vjeçare nga data e depozitimit. Afati i mbarimit të mbrojtjes për këtë markë është data 18/01/2028, me të drejtë ripërtëritje çdo 10 vjet.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, | | |
| 8 | 11/05/2022 | Pershendetje,<br><br>Uroj te jeni mire me pune dhe shendet.<br>Me qellim regjistrimi e nje patente ne Shqiperi dhe per | 16/05/2022 | Kerkesa qe ju keni parashtruar konsiderohet kerkese per hetim mbi objektet e Pronesise Industriale dhe shoqerohet me pagesen perkatese prej 2000 ALL.<br><br>Kete sherbim e gjeni ne portalin e-Albania. | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | transparence, ju lutem me vendosni ne dispozicion listen e patentave kombetare qe gezojne mbrojtje.<br><br>Faleminderit, | | Gjithashtu ju mund te aksesoni ne linkun bashkelidhur ku eshte regjistri online i objekteve te pronesise industriale i cili perditesohet cdo dite.<br><br>http://regjistriobjektevepi.dppi.gov.al/wopublish-search/public/patents?1&query=*:* | | |
| 9 | 08/08/2022 | Pershendetje, gjate aplikimit per ndryshim te pronarit te markes eshte bere nje gabim drejtshkrimor ne emrin e pronarit te ri. Meqenese tashme ka dale "Njoftimi per regjistrimin e transferimit te pronesise", per saktesimin e emrit te pronarit te ri nepermjet aplikimit nga e-Albania, duhet te perdor formulari ne rubriken: "APLIKIM PËR REGJISTRIMIN NË REGJISTËR TË NDRYSHIMEVE TË MARKAVE" apo ndonje formular tjeter duke paguar dhe vleren prej 2000 Leke sipas pikes 5.31 "Tarifë për saktësimin e të dhënave në regjistër." te VKM nr. Nr.883, datë 13.5.2009, mbi | 17/08/2022 | Ne pergjigje te emailit tuaj, ju bej me dije se pergjigjja e kerkeses suaj te meparshme per ndryshim pronesie te markes , me gabim, tashme eshte reflektuar ne regjister. Per kete arsye, formulari i duhur ne rastin konkret eshte :"APLIKIM PËR REGJISTRIMIN NË REGJISTËR TË NDRYSHIMEVE TË MARKAVE".<br>Prej dates 1 maj 2022 ju mund te aplikoni vetem nepermjet e-Albanias. | E-mail i perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | tarifat (i ndryshuar)? | | | | |
| 10 | 12/09/2022 | Duke qene se sherbimet tashme ofrohen online, kemi nevoje per informacion te detajuar mbi mbrojtjen e nje shpikjeje, apliki (linku), tarifat , afati dhe dokumentacionin perkates.<br>Ne faqene Webit, nuk gjejme dot formularin e aplikimit per shpikje.<br>Mirepresim sa me shpejt nje pergjigje tuajen. | 13/09/2022 | Ne pergjigje te email-it tuaj ju bej me dije se ne faqen web te DPPI: dppi.gov.al, do te gjeni informacion shterues per patentat per shpikjet, per markat tregtare, per proceduren e regjistrimit, bazen ligjore ku mbeshtetet regjistrimi i tyre dhe VKM nr. 883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, i ndryshuar. Gjithashtu, informacioni i detajuar dhe formularet jane ne platformwn e-Albania, te cilen mund ta aksesoni edhe nepermjet rubrikes e-Sherbime; e-filing, te faqes web te DPPI: dppi.gov.al.<br><br>Ju keshillojme ne perfundim, te konsultoni nenin 195 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar, qe parashikon kriteret e perfaqesimit ne DPPI. | E-mail i përfunduar | 0 |
| 11 | 08/09/2022 | Informacion per te regjistruar emrat e bizneseve te tyre dhe logove qe perdorin.<br>Ju lutem, me informoni pal me linkun e aplikimit nese behet online, dhe nje sqarim per secilen, si te procedoj me regjistrimin e emrit dhe logos. | 13/09/2022 | Ne pergjigje te email-it tuaj ju bej me dije se ne faqen web te DPPI: *dppi.gov.al,* do te gjeni informacion shterues per patentat per shpikjet, per markat tregtare, per proceduren e regjistrimit, bazen ligjore ku mbeshtetet regjistrimi i tyre dhe VKM nr. 883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin | E-mail i perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e objekteve të pronësisë industriale", i ndryshuar.<br>Gjithashtu, informacioni i detajuar dhe formularet jane ne platformen e-Albania, te cilen mund ta aksesoni edhe nepermjet rubrikes e-Sherbime; e-filing, te faqes web te DPPI: *dppi.gov.al.*<br>Ju informojme ne vijim se në DPPI regjistrohen objektet e pronesise industriale, ndersa emrat tregtarë regjistrohen ne QKB.<br><br>Ju keshillojme ne perfundim, te konsultoni nenin 195 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar, qe parashikon kriteret e perfaqesimit ne DPPI. | | |
| 12 | 12/10/2022 | Te me vendosni ne dijeni ne lidhje me proceduren e regjistrimit te nje kontrate ekzlusiviteti | 21/10/2022 | Ne pergjigje te emailit tuaj ju bej me dije se ju mund te beni nje aplikim ne platformen e-Albania (nepermjet rubrikes E-filing te faqes sone web: dppi.gov.al) per ndryshime ne regjister lidhur me objektin e pronesise industriale per te cilin ju keni lidhur nje kontrate ekskluziviteti.<br>Pasi te hyni tek ky sherbim kryesor, aty do te zgjidhni: Regjistrim i kontrates se licences... dhe do te vijoni me plotesimin e formularit.<br>Ne kartelen shoqeruse te sherbimit, ne platformen e-Albania, ju do te merrni | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | informacion te nevojshem per sa me siper.<br><br>Ju gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, të cilët janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës se pronesise industriale. Listën e përfaqësuesve të autorizuar e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: *http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/* . | | |
| 13 | 13/12/2022 | Isha i interesuar rreth patentave ose ekskluzivitetit te nje produkti.Jam ne dijeni qe duhet dhe nje kontrate me kompanine te cilen kryej marrveshje,por doja tu informoja dhe per procedurat ne Shqiperi.Produkti ne fjale eshte nje zevendsues duhani,shume i njohur ne vendet e zhvilluara te | 14/12/2022 | Në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë se:<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205 | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | europes,por ne Shqiperi akoma nuk ka hyre ky produkt ne treg.Doja tu interesoja se si funksionon puna e patentes ne Shqiperi,a mund ta kem vetem une produktit ne fjale si distributor i Shqiperise dhe neqoftese po marr info ne vendin e gabur shpresoj te me drejtoni drejt rruges se duhur | | &service_type=Y .<br><br>• **Në platformen e-Albania do të kërkoni shërbimin kompleks: <u>Aplikim për regjistrimin në regjistër të ndryshimeve të patentës për shpikje</u>**. Ndër opsionet që shfaqen duhet përzgjedhur shërbimi: ***Regjistrimi në regjistër të kontratës së licencës për patentën për shpikje.*** Ndiqni ju lutem udhëzimet shteruese që ofrohen në faqen e gjeneruar në platformën e-Albania. Përkatësish linku: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13416<br><br>• Në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 14 | 27/01/2023 | Per te bere aplikimin per marken me nenshkrim elektronik, mund ta bej si person fizik (kam nje nipt te hapur si aktivitet i perkthyesit zyrtar te licensuar), deri sa te hap Nipt per agjensine turistike si shoqeri tregtare? | 30/01/2023 | Ju informojme se bazuar ne pikes 1 te nenit 145 te Ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 "PËR PRONËSINË INDUSTRIALE", i ndryshuar, *"Kërkesa për të fituar të drejtën mbi një markë mund të bëhet* ***nga çdo person****"*; dhe sipas pikes 2.1.11 te nenit 3 te VKM Nr. 315, datë 31.5.2018, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MARKAT" formulari i aplikimit duhet te permbaje *"Nënshkrimin e aplikantit ose të përfaqësuesit të tij"*.<br><br>Ne rastin e aplikimit permes formatit elektronik sipas Neni 192/b te Ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 "PËR PRONËSINË INDUSTRIALE", i | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ndryshuar, *"Çdo aplikim/kërkesë në format elektronik duhet të shoqërohet me nënshkrimin elektronik, sipas legjislacionit në fuqi."* | | |
| 15 | 10/03/2023 | Ju lutem me duhet te bej regjistrimin e market time ne kete institucion. Paraprakisht doja te merja nje iformacion mbi emrin(marken) qe dua te regjistroj, A eshte e mundur ta di paraprakisht nese emri(marka) qe dua une eshte apo jo I lire. Do me ndihmonit shume nese mund ta kem kete informacion | 13/03/2023 | Në vijim të emailit tuaj ju informojmë se që prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Hetimi i objekteve te pronesise industriale kryhet përmes portalit e-Albania duke aplikuar shërbimin "Aplikim për hetim për objektet e pronësisë industriale". Për më shumë informacion mbi aplikimin: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13430 .<br><br>Gjithashtu, në mbështetje të nenit 192/b të ligjit nr.9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar, ju mund të kryeni kërkim pa pagesë në faqen web zyrtare të | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | DPPI: *dppi.gov.al*, e cila përditësohet mesatarisht çdo ditë.<br><br>Në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 16 | 20/03/2023 | Dua te informohem si mund te certifikohem si perfaqesues i autorizuar per markat dhe disenjot industrial, per te marr pjese ne provim. | 21/03/2023 | Për tu informuar lidhur me procedurën e certifikimit si përfaqësues i autorizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, lutemi të konsultoheni me ***VENDIMIN Nr. 317, datë 31.5.2018 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE"****(e gjeni bashkëngjitur).*<br><br>Bazuar në **Vendimin** | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **numër 4, datë 20.06.2022, "Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik" të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI)** *(e gjeni bashkëngjitur)*:<br><br>• Dokumentet që duhet të paraqiten originale ose të noterizuara, si dhe dokumentet shoqëruese të kërkesës që nuk mund të ngarkohen në format elektronik në platformën "e-Albania", i dërgohen DPPI-së në rrugë postare. Në këto raste kërkesa për marrjen e shërbimit dërgohet nëpërmjet platformës "e-Albania".<br><br>• Sipas "ANEKSI I" Lista e dokumenteve që duhet të dërgohen me postë në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | DPPI:<br>• -Autorizimet e përfaqësimit, ose prokurat;<br>-Kontratat e licensës dhe kontratat e transferimit të pronësisë;<br>-Çdo dokument provues që legjislacioni kërkon të jetë original apo i noterizuar;<br>-Pretendimet e noterizuara;<br>-Dokumentet provuese që legjislacioni parashikon të depozitohen origjinale ose të noterizuara.<br>-Akte noteriale. | | |
| 17 | 06/04/2023 | Kam bere nje aplikim per regjistrim kombetar te markes tregtare dhe me ka ardhur pergjigja qe duhet te beje plotesimin ee elementeve formale te | 06/04/2023 | Në vijim të emailit tuaj ju komunikojmë se:<br>-Njoftimi ju orienton të kryeni plotësime dhe jo të riaplikoni.<br>-Deri në përfundim të zhvillimit të sistemit të ri në bashkëpunim me AKSH-in, për komunikimin e ndërmjetëm online, | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kerkeses.<br>Mund te me tregoni ju lutem si duhet te procedoje? | | plotësimet e të metave të kërkesës **do të dërgohen me postë. Plotësimet në formular duhet të kryhen me shkrim shtypi.**<br>**Ju lutemi, mos harroni të nënshkruani formularin.** | | |
| 18 | 07/04/2023 | Ju lutem brenda mundesive, kerkoj suportin tuaj per tu informuar ne lidhje me procedurat qe duhen ndjekur per ''patentimin e nje softwer-i''. | 11/04/2023 | Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju informojmë se bazuar në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar, programet kompjuterike (software) nuk patentohen.<br><br>Për t'u informuar lidhur me mbrojtjen e programeve kompjuterike (software), drejtohuni në Drejtorinë e të Drejtave të Autorit (DDA), në varësi të Ministrisë së Kulturës, Tiranë | E-mail Perfunduar | 0 |
| 19 | 08/04/2023 | Kam nje ide dhe dua te aplikoj per te marre patenten industriale. Per momentin jetoj ne New York. Po pati mundesi me shkruani cfare jane hapat dhe se sa eshte pagesa. Gjithashtu ku eshte adresa ne Shqiperi sepse kam ndermend te vij se shpejti. | 11/04/2023 | Në vijim të emailit tuaj ju informojmë se:<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | .aspx?<br>service_filter=INS&<br>institution_id=205<br>&service_type=Y<br>• Në lidhje me patentimin e shpikjeve bashkëngjitur gjeni broshurën e cila përmban informacion shterues.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 20 | 13/04/2023 | Nje klient i imi ka nje studio tatuazhesh... Eshte person fizik dhe don te aplikoje regjistrim logoje dhe autenticitet te logos. Me sakte do te beje regjistrimin e markes;<br>Sipas ligjit 9947 date 07/07/2008, neni 154.<br><br>Si mund te | 13/04/2023 | • Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?<br>service_filter=INS&<br>institution_id=205 | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pocedoj.. Nepermjet e-albania apo nepermjet nje email tjeter dhe si mund te procedoj me tej.<br><br>Lutem si mund e gjej mandat pagesen. | | | &service_type=Y .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, "Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik" të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 21 | 25.04.2023 | Would you please assist us with some doubts regarding the renewal payment?<br><br>After a patent is granted, should we only pay for the current annuity at that | 27.04.2023 | In response to your email, I inform you that subjects who do not have permanent residence in the Republic of Albania or who do not carry out activities in its territory, can apply to the GDPI only through the intermediation of Albanian authorized representatives of PI.<br><br>So, you have to appoint | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | year, or should we pay for the sum of the previous annuities?<br><br>And after a patent is granted, what is the latest day to pay the annuities due at that moment, before it enters in surcharge? | | an Albanian representative certified as such by the GDPI.<br><br>I'm sending you the link to the Register of Representatives on our web page: *http://dppi.gov.al/en/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/*<br><br>Once the page is open, you have to click on the writing: Klikoni këtu për të hapur Rregjistrin.<br><br>After that, the list of all representatives will appear.<br><br>You can find comprehensive information in English (including the amended law no. 9947, date 07.07.2008 "On Industrial Property") on our web page: *dppi.gov.al*. | | |
| 22 | 03.05.2023 | Kam ber dhe nje makineri qe mbushen fugat dekorative cfar duhet per patent un e kam dhe punoj me kte makineri mund ta sjellë tek ju ose diku ku und | 03.05.2023 | Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) është institucioni i vetëm nëpërmjet të cilit shteti shqiptar jep të drejtat mbi patentat mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit, topografinë e produkteve gjysmëpërçues, markat tregtare dhe të shërbimit, | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | te testohet. | | disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, duke iu njohur mbajtësve të së drejtave pronësinë mbi këto objekte, nëpërmjet regjistrimit të tyre.<br><br>Por, DPPI nuk kryen testime në kuptim të pyetjes suaj. | | |
| 23 | 23.05.2023 | Kërkoj një informacion për Regjistrimin Kombëtare të Markës. Ju lutem mund të më informoni si më poshtë:<br><br>si titullohet formulari ne e-albania<br>nje orientim për plotësimin e formularit<br>cilin nga zërat e e Seksionit B pika 7 me duhet te selektoj.<br>Tek formulari me kerkohet qe te ngarkoj faturen e paguar por kur me gjenerohet fatura per ta paguar dhe ngarkuar tek formulari ne e-albania? | 23.05.2023 | Në lidhje me regjistrimin kombëtar të markës, ju informojmë se:<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: [http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/](http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/) . | | |
| 24 | 27.04.2023 | Jemi nje kompani programimi,dua te marr informacion lidhur me patentimin dhe mbrojtjen e nje software qe kemi ndertuar i cili do te ofroje sherbime si text to speech dhe speech to text ne gjuhen shqipe.Kete gje ne do e shesim si sherbim tek pale te tjera per ta patur ne perdorim me license per nja afat te caktuar kohor.Mund te me orientoni sesi duhet te veproj? | 08.05.2023 | Duke ju kërkuar ndjesë për vonesën në pergjigje, pasi emaili juaj u gjend i arkivuar tek kategoria "Spam/Junk Email", ju informojmë se:<br><br>-Në bazë të nenit 189, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni publik që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së, të cilat janë markat tregtare, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, disenjot industriale, patentat dhe modelet e përdorimit, topografitë e qarqeve të integruara, varietetet bimore. | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | -Referuar Ligjit Nr. 35/2016 "PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO", programet kompjuterike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit.<br><br>Për sa më sipër, ju lutemi drejtohuni Drejtorisë për të Drejtat e Autorit. | | |
| 25 | 28.04.2023 | Po ju shkruaj për të marr informacion në lidhje me markat tregtare.<br>Për mbrojtjen nga cënimi i emrit tregtar të markës, përveç listës së mallrave dhe/ose shërbimeve të deklaruara në fillim në momentin e regjistrimit të markës a vlen bërja e aplikimit për ndarjen e aplikimit fillestar për regjistrim marke, për të shtuar listë shtesë të mallrave/shërbimeve? | 08.05.2023 | Referuar pikës 6 të nenit 145 të Ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, "*pas datës së lëshimit të dëshmisë së depozitimit nga DPPI-ja, ndalohet të bëhen shtesa në listën e mallrave ose shërbimeve apo ndryshime në pamjen e markës, përveç rasteve që lidhen me bërjen e korrigjimeve ortografike ose saktësimeve në listën e mallrave ose shërbimeve*".<br><br>Lidhur me ndarjen e kërkesës fillestare, lutemi të konsultoheni me përmbajtjen e nenit 149 të Ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, si më poshtë:<br>*1. Me kërkesë të aplikantit, çdo aplikim fillestar, që u referohet* | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *mallrave ose shërbimeve të ndryshme, mund të ndahet në dy ose më shumë kërkesa.*<br>*2. Kërkesat e ndara mbajnë datën e depozitimit të kërkesës fillestare dhe gëzojnë të drejtën e prioritetit, nëse aplikimi fillestar e gëzon këtë të drejtë.*<br>*3. Kërkesa për ndarjen e një aplikimi mund të bëhet para se të merret vendimi për regjistrimin e markës.*<br>*4. Për çdo ndarje të një kërkese paguhet një tarifë e caktuar.*<br><br>Për më shumë informacion, bashkëngjitur gjeni Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar. | | |
| 26 | 08.05.2023 | Kërkojmë të bëjmë disa ndryshime të pronarit të markes tregtare për shkak se kanë ndryshuar aksioneret dhe administratori si dhe ndryshimin e logos.<br><br>Nga rublikat e aplikimit në e-albania nuk është e qartë se cila nga këto zëra është | 08.05.2023 | Në vijim të emailit tuaj ju informojmë se:<br><br>1.Shërbimet në e-Albania janë funksionale dhe orientuese për përmbajtjen e tyre.<br><br>2.Në rastin e paqartësisë së paraqitur prej jush për mënyrën e aplikimit:<br>-Ndryshimi në përfaqësimin e markës, sjell krijimin e një marke të re, për të cilën duhet bërë një aplikim i ri | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rublika që ne kërkojmë të aplikojmë.<br><br>Numri i telefonit tuaj nuk ekziston, sportel nuk keni, kshu që ju lutem na asistoni me një suport nga ana juaj. | | përmes shërbimit: "Aplikim për regjistrimin kombëtar të markës".<br>-Në rast se përfaqësimi i markës është i njëjtë dhe ka ndryshuar pronësia mbi markën, për të kryer regjistrimin në regjistër të ndryshimit në emër të pronarit të markës, aplikohet shërbimi "Aplikim për regjistrimin në regjistër të ndryshimeve të markës tregtare". | | |
| 27 | 17.05.2023 | Isha i interesuar te dija si procedohet per rinovimin e markave . | 17.05.2023 | Në vijim te emailit tuaj ju informojmë se:<br><br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br>Për të kryer ripërtëritjen e një marke aplikohet përmes portalit shërbimi elektronik "APLIKIM PËR RIPËRTËRITJE TË OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE", ku do të gjeni të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e aplikimit, në linkun si më poshtë:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y | | |
| 28 | 23.05.2023 | Mund te me informoni ne lidhje me regjistrimin e nje marke sipas dokumentit ne attach, ne lidhje me pyetjet si me poshte:<br><br>1. Cili kategorizim mund te pershtatet pasi eshte edhe marke fjale dhe figure?<br><br>2. Sipas klasifikimit te Nises nuk mund te gjeja sherbimin e qiradhenies per kampera, se di nese eshte i perfshire te: dhenia me qira e automjeteve?<br><br>3. Pagesat e aplikimit/klasave/prioritetit kryhet perpara aplikimit?<br>4. Sa eshte koha e nevojshme e regjistrimit standard dhe e atij prioritar | 23.05.2023 | Në lidhje me regjistrimin kombëtar të markës, ju informojmë se:<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Broshurë që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: [http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/](http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/) . | | |
| 29 | 25.05.2023 | Kërkoj informacion në lidhje me regjistrimin e Markës Tregtare (FJALË).<br>Përvec fjalëve, po logoja është e domosdoshme në momentin që kryen aplikimin në E-Albania? | 29.05.2023 | Në lidhje me regjistrimin kombëtar të markës, ju informojmë se:<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y) .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të | E-mail<br>Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 30 | 25.05.2023 | Kerkoj ndihmen tuaj per te regjistruar emrin e nje programi televiziv si marke tregetare, Cilin nga formularet duhet te plotesoj? Dhe aplikimi kryhet ne e-albania? | 29.05.2023 | Në lidhje me regjistrimin kombëtar të markës, ju informojmë se:<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 31 | 05.06.2023 | Jam nje studente drejtesie master ne shkenca civile dhe tema ime e diplomes eshte "Mbrojtja e pronesise industriale ne hapesiren virtuale".<br>Pa ju marre shume kohe doja t'iu beja nje pyetje ne kuadrin e kerkimit tim studimor.<br>Sic e dini tashme zhvillimet me te fundit dhe me interes ne bote sa i perket pronesise industriale jane ato qe lidhen me Metaverse dhe NFT. Pyetja ime eshte e tille: A ka patur tentativa per regjistrimin e NFT si marka tregtare ne Shqiperi? Nese po, si eshte vepruar? Nese jo, a keni ju si | 06.06.2023 | Duke ju falenderuar për interesimin tuaj në fushën e pronësisë industriale dhe duke ju uruar suksese në punimin e temës së diplomës, në vijim të emailit tuaj përcjellim informacionin e mëposhtëm:<br><br>Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të Pronësisë Industriale.<br><br>Me sa kuptohet, ju nevojitet të dini nëse markat "Metaverse" dhe "NFT" janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë. Dhënia e këtij informacionit konsiderohet si "Aplikim për hetim të objekteve të pronësisë industriale", i cili që prej datës 01.05.2022 kryhet vetëm | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | institucion nje plan qe mund te ndiqni nese vjen nje rast i tille? | | përmes portalit e-Albania, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. Gjithashtu, ju mund të kryeni hetim pa pagesë në regjistrin online të DPPI, në faqen zyrtare dppi.gov.al dhe në portalin "Wipo Madrid Monitor" për markat e regjistruara përmes Sistemit të Madridit.<br><br>Për tu informuar në lidhje me procedurën e regjistrimit të një marke dhe veprimet që kryen DPPI gjatë procedurës, bashkëngjitur gjeni:<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat",<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar,<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT,<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”. | | |
| 32 | 02.06.2023 | Jemi te interesuar per regjistrimin e markës tregtare, kompania eshte ne fushën e design dhe | 06.06.2023 | Në lidhje me regjistrimin kombëtar të markës, ju informojmë se:<br><br>• Prej datës 01.05.2022, | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndërtimi, por do te hapim dhe nje zinxhir hotelesh me emër tjetër të ndryshëm nga shoqëria e ndërtimit, konkretisht ju lutem a mund te na informoni:<br>1. Nese mund te bëjmë nje aplikim mqs do jete i njejti NIPT per te 2 emrat (emrin e shoqërisë se ndërtimit, si dhe emrin qe do jete ndryshe i hotelit) per te cilet duam te bëjmë markën<br>2. Kerkojme nje informacion me specifik ne lidhje me kategorinë e markës, ndryshimi mes asaj individuale dhe certifikuese, pasi jemi te paqarte cilën do aplikojmë per sa me sipër<br>3. Aplikimi online përmes e-albania, kërkon dokumentacion si dok. Pagese, i cili duhet te gjenerohet pas miratimit, qe do te thotë ose do e dërgoni përmes postes | | aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | elektronike dhe ta paguajmë e me pas ta ngarkojmë ne sistem<br>4. Si dhe dokumentacion tjetër kërkohet lista e mallrave qe kërkojnë mbrojtje (duhet te listojmë klasat dhe mallrat qe janë edhe ne formular), si dhe dokumente te tjera, ju lutem na informoni nëse kërkohet ndonjë formular përveç atij te aplikimit ne e-albania | | Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues. ***(i cili shkarkohet pasi plotësohen të dhënat dhe është i vetmi formular i kërkuar)***<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT. ***Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesë bashkëngjitet në aplikim.***<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat" ***ku shpiegohet përkufizimi i markës individuale/certifikuese etj.***<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 33 | 01.06.2023 | Kerkoj te bej ndryshime ne marken tregtare qe eshte e regjistruar dhe e aprovuar nga ana juaj.<br><br>Do te doja te me ndihmonit me informacion lidhur me sherbimin qe duhet te perzgjedh ne e-albania per kete aplikim. | 06.06.2023 | Aplikimi që duhet të kryhet në e-Albania është "**Aplikim për regjistrimin në regjistër të ndryshimeve të markës tregtare".** | E-mail Perfunduar | 0 |
| 34 | 01.06.2023 | Would you please assist us with a doubt: If an EP patent is granted the day before the anniversary of the filing date, would we have only one day to pay before the | 06.06.2023 | In response to your email, I inform you that subjects who do not have permanent residence in the Republic of Albania or who do not carry out activities in its territory, can apply to the GDPI only through the intermediation of Albanian authorized representatives of PI. | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | case enters in surcharge?<br><br>For example:<br>Filling date: 2016-05-21<br>Grant date: 2023-05-20<br>I am wondering if you would have any flexibility related to Paragraph (2) of Article 141 of the European Patent Convention? | | So, you have to appoint an Albanian representative certified as such by the GDPI.<br><br>I'm sending you the link to the Register of Representatives on our web page: http://dppi.gov.al/en/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/<br><br>Once the page is open, you have to click on the writing: Klikoni këtu për të hapur Rregjistrin.<br><br>After that, the list of all representatives will appear.<br><br>You can find comprehensive information in English (including the amended law no. 9947, date 07.07.2008 "On Industrial Property") on our web page: dppi.gov.al. | | |
| 35 | 06.06.2023 | Une qe po ju shkruaj zoteroj distribucionin e disa markave kozmetike dhe jam i interesuar qe keto marka ti mbroj nga falsifikimi, nga shitja e personave te tjere te paautorizuar per shitjen e tyre si dhe nga perdorimi i | 14.06.2023 | Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë se:<br><br>1. Në lidhje me regjistrimin kombëtar të markës:<br><br>• Prej datës 01.05.2022, | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | emrit te markave te mija nga persona te tjere per qellime fitimi.<br><br>Do ju lutesha te me jepnit informacion sesi funksionin procedura dhe cfare hapash duhet te ndjek per mbrojten e markave te mia. | | aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale".<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar.<br><br>2. Në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar të markës, gjeni bashkëngjitur broshurën shpieguese.<br><br>3. Në rast se interesoheni për të kryer regjistrimin e kontratës së licensës në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | regjistrin e markave, ju ftojmë të aplikoni në e-Albania shërbimin "Aplikim për regjistrimin në regjistër të ndryshimeve të markës tregtare", ku do të gjeni informacion mbi kryerjen e aplikimit.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 36 | 16.06.2023 | Jam i interesuar për 2 gjëra:<br>1. Për marrjen e Certifikatës Eksperti PI.<br>2. Për regjistrimin e disa markave biznesi. | 19.06.2023 | Në vijim të emailit tuaj ju informojmë se:<br>Ky email është mjeti i duhur i përcjelljes së informacionit, të cilin ju tashmë e dispononi. Për të marrë informacion mbi legjislacionin, lutemi të hyni në faqen zyrtare të DPPI: dppi.gov.al.<br><br>Për pikën 1 bashkëngjitur gjeni VENDIMIN Nr.501, datë 29.8.2018 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR EKSPERTËT E | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE".<br><br>Në lidhje me regjistrimin kombëtar të markës:<br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale".<br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar. | | |
| 37 | 16.06.2023 | Dua te aplikoj si individ per rregjistrim marke por nuk ma pranon aplikimin pa e nenshkruar elektronikisht formularin. Si duhet te veproj pasi jam individ? | 19.06.2023 | Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë se që prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen ***vetëm nëpërmjet portalit e-Albania*** (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht për aplikimet që kryhen në DPPI linku: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Për të bërë një aplikim formulari duhet nënshkruar elektronikisht nga aplikanti apo përfaqësusi i autorizuar për kryerjen e aplikimit. Ju lutemi, sigurohuni që të jeni të pajisur me nënshkrimin elektronik pasi në mungesë të tij, dërgimi i aplikimit nuk do të jetë i | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mundur. Aplikimi për nënshkrim elektronik kryhet përmes e-Albania. | | |
| 38 | 29.06.2023 | Perfaqesuesit e autorizuar te licensuar nga DPPI a mund ta kryejne regjistrimin kombetar te logos time? | 03.07.2023 | Përfaqësuesit e autorizuar, të licencuar nga DPPI, janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, për tarifat e të cilëve DPPI nuk ka dijeni.<br>Listën e tyre e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | E-mail Perfunduar | 0 |
| 39 | 03.07.2023 | *Situata:* Dua të aplikoj për një ekstrakt nga regjistri i markave të regjistruara përmes e-albania. Bëhet fjalë për një markë ndërkombëtare të regjistruar në Gjermani. Subjekti që përfaqësoj ka kontratë, të depozituar pranë DPPI, me pronarin e markës ndërkombëtare për përdorimin e saj edhe në Shqipëri.<br><br>*Pyetja ime:* A është institucioni që përfaqësoj në këtë rast aplikanti direkt përmes e-albania apo më duhet autorizim nga | 05.07.2023 | Për të marrë një ekstrakt regjistri nga DPPI të një marke ndërkombëtare të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ju duhet të aplikoni përmes e-Albania shërbimin "Aplikim për lëshim ekstrakti nga regjistri i objekteve të pronësisë industriale".<br>Bazuar në Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", tarifa për lëshim ekstrakti është në vlerën 1000 lekë.<br>Për lëshimin e ekstraktit nuk është i nevojshëm autorizimi nga pronari i markës.<br><br>Ose ju mund të shkarkoni ekstrakt pa pagesë përmes faqes së WIPO - MADRID MONITOR në linkun | E-mail Perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | personi juridik i huaj pronar i markës ndërkombëtare? | | https://www3.wipo.int/madrid/monitor/en/ | | |
| 40 | 28/07/2023 | Jam nje qytetare , ne nje televizion do filloj nje Show televiziv idene e te cilit, enrin dhe logon i kam ideuar vete. Doja te dija nese ka nje procedure prane zyrave tuaja ku mund te aplikoj per te mbrojtur : emrin logon por edhe permbajtjen e emisionit ne menyre qe mos ta kopjojne te tjere. Sidomos permbajtjen . Ka nje procedure per kete prane jush? Nese po cfare dokumentash duhen dhe si behet aplikimi ? | 31/07/2023 | -Referuar Ligjit Nr. 35/2016 "PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO", regjistrimi i përmbajtjes së një emisioni, është objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit.<br>Për sa më sipër, ju lutemi drejtohuni Drejtorisë për të Drejtat e Autorit.<br><br>-Në lidhje me regjistrimin kombëtar të markës, ju informojmë se:<br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y . | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 41 | 31/07/2023 | Jam ne process aplikimi per rregjistrim marke por nuk gjej sa eshte tarifa nese duhet te aplikoj per ekzaminim jashte numrit rendor ? | 31/07/2023 | Gjate aplikimit ju orientoheni nga sistemi per plotesimin e fushave te cilat jane bosh. Tek seksioni per te dhenat e perfaqesuesit te autorizuar, mund te plotesoni te dhenat e administratorit. Ne rast mangesie te te dhenave te domosdoshme, do te njoftoheni gjate ekzaminimit te aplikimit per te kryer plotesimet. Ne lidhje me tarifat bashkengjitur gjeni Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale". | E-mail I perfunduar | 0 |
| 42 | 24/07/2023 | Kompania ne te cilen une punoj | 31/07/2023 | -Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | eshte duke realizuar nje Marreveshje jo eksluzive per Marketing te perbashket me nje tjeter kompani, duke pretenduar gjithashtu te perfitoje te drejten e perdorimit te Markes se regjistruar ne emer te kesaj kompanie (licensuesit). Interesohem lidhur me proceduren qe duhet ndjekur,afatet, menyren se si behet aplikimi, dokumentacionin qe duhet paraqitur dhe kostot qe detyrohemi. | | nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y.<br><br>-Për të kryer regjistrimin e kontratës së licensës në regjistrin e markave, ju duhet të aplikoni përmes postalit e-Albania shërbimin: "Aplikim për regjistrimin në regjistër të ndryshimeve të markës tregtare", ku do te gjeni informacionin e nevojshëm në lidhje me kryerjen e aplikimit.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 43 | 29/09/2023 | Lutem, nese eshte e mundur suportin tuaj per sqarimin e disa ceshtjeve lidhur me aplikimin per regjistrimin e nje marke tregtare dhe konkretisht ne plotesimin e | 03/10/2023 | Në faqen tonë web: dppi.gov.al, në rubrikën "Legjislacioni", do të gjeni VKM nr. 883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, i ndryshuar. | E-mail I përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | formularit.<br><br>Se pari lidhur me pagesen, sipas informacionit ne e-albania, tarifa baze per marke individuale eshte 7,000 leke dhe 2,500 leke per cdo klase shtese. Nese subjekti qe kerkon te regjistroje marken ofron disa sherbime nen kete marke te tilla si: sherbimin e berberit, bar-kafe dhe tabakino dhe kerkon mbrotjen e te gjitha sherbimeve te sipercituara nen marken tregtare qe do te regjistroje duhet te paguaje tarifen baze prej 7,000 leke dhe 5,000 leke per dy klasa shtese?<br>r<br>Ne formular, ne rubriken "Lista e mallrave dhe sherbimeve" ne hapesiren e titulluar "Klasa" duhen listuar kodet e sherbimeve apo mallrave sipas klasifikimit te Nices? Nese duhen cituar konkretisht kodet, lutem mund te me informoni cilat jane kodet per sherbimet: 1) berber, 2) bar-kafe, | | Ju informojmë se plotësimi i kodeve të ngjyrave është jo i detyrueshëm nëse nuk i dispononi ato.<br><br>Ju bëjmë me dije gjithashtu se, në rast nevoje ose paqartësie, mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI-ja, të cilët janë profesionistë të lire,<br><br>specialistë të fushës se PI. Listën e përfaqësuesve të autorizuar e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë ëeb, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3) tabakino.<br><br>Ne rubriken e "Sistemet nderkombetare te ngjyrave", cilin opsion duhet te zgjedhim nese marka qe kerkojme te regjistrojme eshte vetem me ngjyre te zeze si dhe cili eshte kodi i kesaj ngjyre? | | | | |
| 44 | 03/10/2023 | Doja te dija cilat jane rregullat apo procedurat qe duhet te ndiqen per shitblerjen e nje Marke Tregtare. Kam kontrolluar ne legjislacion por nuk gjej percaktime ligjore mbi formen e ketij transaksioni apo rregulla te tjera qe kerkohen te zbatohen per kete lloji transaksioni.<br><br>Ju lutem me informoni nese duhet ndjekur nje forme e caktuar kontrate shitje, apo nese ka rregulla specifike per shitblejren e markes. Ne te kundert me konfirmoni nese shitblerja e nje Marke behet me nje kontrate te | 04/10/2023 | Marrëveshja për transferimin e pronësisë së një marke tregtare bëhet përpara noterit sipas standardit të një kontrate të zakonshme, ku në bazë të Kodit Civil të RSH dhe akteve në zbatim të tij duhet të jenë të deklaruara qartë palët kontraktuese, shprehja e vullnetit të tyre të lirë, objekti i kontratës, data e hyrjes në fuqi të kontratës, të drejtat dhe detyrimet e palëve, etj.<br><br>Aplikimi për regjistrimin në regjistër transferimit të pronësisë bëhet në portalin e-Albania ku do të zgjidhni shërbimin kryesor: “Aplikim për regjistrimin në regjistër të ndryshimeve të markave”, në të cilin do të përzgjidhni opsionin: “Transferim i pronësisë” ose “Transferim i pjesshëm i pronësisë” (sipas rastit).<br><br>Në faqen e shërbimit kryesor, në portalin e-Albania, do të gjeni | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | thjeshte shitblerje (noteriale ose jo). | | informacion shtesë shterues.<br><br>Gjithashtu, ju, pasi të aplikoni, duhet të dërgoni kontratën origjinale ose të noterizuar me postë në adresën e DPPI-së së bashku me autorizimin e përfaqësimit original, në rast se do të caktoni një përfaqësues.<br><br>Konsultoni ju lutemi nenin 162 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar dhe nenet 33 e 34 të VKM nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat" i ndryshuar!<br><br>Ju bëjmë me dije gjithashtu se, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI-ja, të cilët janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës se PI. Listën e përfaqësuesve të autorizuar e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ | | |
| 45 | 09/10/2023 | Jam producenti dhe drejtori artistik i nje eventi qe ne 2005 dhe dua te bej rregjistrimin e | 09/10/2023 | Në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës ju informojmë se:<br>Prej datës 01.05.2022, | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | markes.<br><br>Na udhezoni per proceduren ju lutem. | | aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y.<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | -Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 46 | 12/10/2023 | Ju kontaktoj sepse duhet te regjistroj marken (logon) por doja te dija nese mund ta regjistrojme si person fizik e jo shoqeri e nese mund te jete ne pronesi te dy personave. Gjithashtu me duhet nje mandat | 12/10/2023 | Ne vijim të emailit tuaj, ju përcjellim të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës:<br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e- | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pagese qe te bej pagesen per te bere me pas aplikimin ne ealbania. | | albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y.<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, "Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik" të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 47 | 17/10/2023 | Kerkojme te regjistrojme emrin e hotelit. Cfare procedure duhet dhe dokumentacioni kerkuar. | 18/10/2023 | Në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës ju informojmë se:<br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y.<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | -VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar. Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 48 | 24/10/2023 | Duke ju uruar dite dhe pune te mbare kisha nevoje per disa informacione se si mund ta regjistroj markene e biznesit tim online.<br>Me posht po ju bashkengjis logon e biznesit qe dua te rregjistroj. | 24/10/2023 | Në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës ju informojmë se:<br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 49 | 14/11/2023 | Jam i interesuar të nis një proçedurë ligjore për të çertfikuar mbrojtje ligjore për një produkt, por nuk di ku ta kategorizoj në objekt<br><br>Dmth, nëse është model përdorimi apo dizenjo industriale. | 15/11/2023 | Në lidhje me procedurën për regjistrimin e disenjos industriale, bashkëngjitur gjeni:<br>• Broshurën që ju informon në lidhje me procedurën.<br>• VENDIM Nr. 270, datë 16.5.2018 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR DISENJOT INDUSTRIALE”.<br>• VKM Nr.883, datë 13.5.2009 “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR REGJISTRIMIN E OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE”, i ndryshuar.<br>• Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br>• Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 50 | 07/11/2023 | Desha te informohesha per regjistrimin e 1 logoje biznesi . Biznesi duhet te hapet me nipt qe te behet regjistrimi apo pas marrje nipti? Dhe ju lutem ku behet si regjistrim I logos te e albania? Te e albani administrator apo me nipt ? Dhe duhet bere ndonje pagese apo jo? | 10/11/2023 | Në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës ju informojmë se:<br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, "Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik" të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI). | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 51 | 08/11/2023 | Une qe po ju shkruaj jam Taulant Sinani. Operoj ne fushen e teknologjisë, se fundmi kam ndërtuar nje Aplikacion te cilin me duhet tia shes nje subjekti tregtare. Desha te me ndihmoni me nje informacion mbi dokumentacionin dhe procedurat qe duhet te kryej per te patur te drejten e pronesise dhe te shitjes se Aplikacionit. | 08/11/2023 | -Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë se në bazë të nenit 189, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni publik që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së, të cilat janë markat tregtare, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, disenjot industriale, patentat dhe modelet e përdorimit, topografitë e qarqeve të integruara, varietetet bimore.<br><br>-Referuar Ligjit Nr. 35/2016 "PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO", programet kompjuterike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit.<br><br>Për sa më sipër, ju lutemi drejtohuni Drejtorisë për të Drejtat e Autorit. | E-mail I perfunduar | 0 |
| 52 | 21/11/2023 | Në vijim të korrespondencës sonë të | 23/11/2023 | Në emailin e mëparshëm, bashkëngjitur tij, ju është vënë në dispozicion | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përbashkët me anë të këtij email ju kemi kërkuar formalitetet ligjore për aplikimin për regjistrim të dizenjos industriale, aplikim i cili bëhet në e-albania.<br><br>Nga ana juaj na janë vënë në dispozicion tarifat, formulari i pagesës, kuadri ligjor në fuqi etj.<br><br>Kërkjomë të informohemi prej jush, me anë të këtij email në lidhje me :<br>Faktin nëse e pengon aplikimin mospasja e një dokumenti prioriteti, si dhe pagesa paraprake.<br><br>Gjithashtu kërkojmë të dijmë, se për sa kohë aplikimi merret në shqyrtim dhe sesi proçedohet më tej prej jush, | | informacion shterues, ku përfshihen dhe përgjigjet për pyetjet tuaja mbi afatet e kohëzgjatjes së procedurës dhe mënyrën e kryerjes së aplikimit.<br><br>Ju lutemi të lexoni me vëmendje materialet e dërguara, konkretisht:<br><br>Në lidhje me pagesën përcaktohet qartazi detyrueshmëria e paraqitjes së këtij dokumenti, sipas nenit 6 të VENDIMIT Nr. 270, datë 16.5.2018 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR DISENJOT INDUSTRIALE”:<br><br>1. DPPI-ja ekzaminon nëse aplikimi për disenjo përmban elementet, si më poshtë vijon:<br>1.1 Formularin e aplikimit “Për regjistrim disenjo industrial”;<br>1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit;<br>1.3 Përfaqësimin e disenjos sipas kërkesave të ligjit dhe të kësaj rregulloreje;<br>1.4 Dokumentin origjinal të pagesës së tarifës së depozitimit. Nëse një aplikim për disenjo industriale i plotëson këto kushte, DPPI-ja lëshon dëshminë e depozitimit për aplikimin dhe si datë depozitimi caktohet data e paraqitjes | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në lidhje me aplikimin për regjistrim të dizenjos industriale. | | së aplikimit.<br>2. Kur aplikimi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, DPPI-ja i kërkon aplikantit të plotësojë të metat brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit.<br>3. Nëse aplikimi i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, brenda afatit të caktuar, DPPI-ja lëshon dëshminë e depozitimit dhe cakton si datë depozitimi për aplikimin datën kur përgjigjja për plotësimin e të metave të paraqitet në DPPI.<br>4. Nëse të metat nuk plotësohen brenda afatit dymujor, DPPI-ja refuzon të depozitojë aplikimin dhe njofton aplikantin për vendimin e refuzimit.<br><br>Në lidhje me depozitimin e dokumentit të prioritetit në nenin 8 të VENDIMIT Nr. 270, datë 16.5.2018 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR DISENJOT INDUSTRIALE” të cilin e citojmë:<br><br>"Në rast se pretendohet për prioritet, aplikanti duhet që, brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së aplikimit, të depozitojë pranë DPPI-së dokumentin e prioritetit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | në bazë të pikës 4, të nenit 119, të ligjit ose certifikatën e lëshuar nga autoritetet kompetente të ekspozitës, ku është paraqitur produkti, në bazë të pikës 2, të nenit 120 të ligjit.",<br>kuptohet se dokumenti i prioritetit nuk është i detyrueshëm pët t'u depozituar, por depozitohet në rast se pretendohet për prioritet.<br>Në lidhje me afatet ligjore për kohëzgjatjen e procedurës, ju lutemi të rishikoni me vëmendje ligjin dhe vkm e bashkëngjitur (të njëjta me emailin e mëparshëm).<br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ | | |
| 53 | 30/11/2023 | Interesohem per regjistrimin e markes se biznesit!<br>I kam marre informacionet nga ealbania per | 01/12/2023 | Në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës ju informojmë se:<br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e- | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dokumentat te cilat nevojiten por nuk di vleren se sa do te paguaj, ju lutem mund tme jepni nje informacion se si funksionon dhe hapat qe duhet te ndjek! | | Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | -Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale".<br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar.<br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 54 | 01/12/2023 | Desha te dija se si mund te | 04/12/2023 | Në bazë të nenit 189, të ligjit nr. 9947, datë | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | veproj per trademark per disa suplemente vitaminash qe po mendoj te fus ne tregun shqiptar. Kam 4 lloje te ndryshme dhe investitori eshte indian me nipt ketu ne shqiperi prej dy vitesh. | | 07.07.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni publik që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së, të cilat janë markat tregtare, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, disenjot industriale, patentat dhe modelet e përdorimit, topografitë e qarqeve të integruara, varietetet bimore. | | |
| 55 | 05/12/2023 | Pershendetje, doja te regjistroja nje emision ne emrin tim.si mund te aplikoj? | 05/12/2023 | Në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës ju informojmë se:<br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br>-VKM Nr. 315, datë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat". -Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar. | | |
| 56 | 07/12/2023 | Duke ju uruar pune te mbare, kemi nevoje per informacion, persa i perket procedures dhe dokumentave, mundesisht edhe linkut ne ealbania per regjistrim marke (logo dhe emer) dhe regjistrim patente industriale. | 07/12/2023 | Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin | E-mail I perfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës.<br>Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>Bashkëngjitur këtij email-i gjeni materialet informuese të nevojshme në lidhje me:<br><br>Procedurën për regjistrimin kombëtar të markës:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Procedurën për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | regjistrimin kombëtar të disenjos industriale:<br>-Broshurën që ju informon në lidhje me procedurën.<br>-VENDIM Nr. 270, datë 16.5.2018 "Për miratimin e rregullores për disenjot industriale".<br>-VKM Nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", i ndryshuar.<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>Procedurën për regjistrimin për patenë për shpikje:<br>-Broshurën që ju informon në lidhje me procedurën.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar.<br>VENDIM Nr.1707, datë 29.12. 2008 "Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | për shpikjet dhe modelet e përdorimit”.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 57 | 09/01/2024 | Te nderuar, deshiroj te kem disa informazione. Perfaqesoj me prokure notarile nje person fizik te huaj qe deshiron te rregjistrje nje marke ne Shqiperi. Depozitimi i kerkeses behet online apo dhe me shkresa prane zyrave tuaja?<br>Nese mund te behet dhe dorazi ku mund ta shkarkoj formularin FM1? | 10/01/2024 | Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës, si më poshtë :<br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 58 | 10/01/2024 | Momentalisht jemi duke u perpjekur te regjistrojme te disa komponenteve te markes per nje projekt qe jemi duke ndjekur dhe me gjithe mundin per te kuptuar aplikim ne e-Albania, po e gjejme te pamundur qe te orientohemi.<br>Ne duam te vijojme me | 11/01/2024 | Përshëndetje,<br><br>Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës, si më poshtë :<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e- | E-mail | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbrojtjen e platformes dhe te logos se nje aplikacioni qe po ndertojme.<br>Nese e keni te mundur, a mund te na ndihmoni me shpjegimin e procedures qe duhet te ndjekim per te kryer aplikimin? Ne e-Albania thuhet qe aplikimi kerkon 261 dite te shyqrohet ndaj duam te shmangim cdo gabim qe mund te na ktheje ne piken 0 pasi te kemi kryer aplikimin.<br>Disa nga pikat qe nuk kuptojme ne e-Albania jane ato te lidhura me Raportin e investigimin, Ekzaminim jashte nr rendor, Lloji i Markes, Dallimi mes markes Kolektive dhe Individuale etj. Duke qene se nuk kane nje info point tek kerkesa nuk e identifikojme dot se cfare | | albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | informacioni duhet te perfshijme ne sejcilen pike. | | për subjektin aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 59 | 24/01/2024 | Ju lutem nese mund te me jepni nje informacion. A eshte e mundur qe te mbrohet nga ligji, nje bocet / projekt | 25/01/2024 | -Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë se në bazë të nenit 189, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni publik që | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | per te realizuar nje skulpture ne hapsire publike, perpara se te realizohet vepra? Ne menyre qe mos te jete rreziku qe dikush tjeter ta realizoje kete veper perpara. Egziston nje lloj patentimi ose e drejte e autorit per vepren e artit perpara se kjo te realizohet, duke e pershkruar shume mire ne nje bocet me imazhe dhe shkrim, se si do jete vepra dhe ku do te vendoset? | | regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së, të cilat janë markat tregtare, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, disenjot industriale, patentat dhe modelet e përdorimit, topografitë e qarqeve të integruara, varietetet bimore.<br><br>-Referuar Ligjit Nr. 35/2016 "PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO", veprat e artit janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit.<br><br>Për sa më sipër, ju lutemi drejtohuni Drejtorisë për të Drejtat e Autorit. | | |
| 60 | 30/01/2024 | Doja t'ju pyesja ne lidhje me traifat e regjistrimit te nje marke tregtare qofte kombetare, si edhe nderkombetare. Gjithashtu, doja te dija nese mund te me shpjegoni mbi kuptimin e termit "çdo klase shtese" duke qene se nuk ka nje shpjegim te caktuar ne faqen | 01/02/2024 | Në lidhje me regjistrimin kombëtar të markës tregtare: Nëse mallrat dhe/ose shërbimet e interesit tuaj përfshihen vetëm në një klasë të klasifikimit të Nicës, pagesa që duhet kryer është 7000 lekë, ndërsa në rastin e markave kolektive dhe certifikuese pagesa bazë është 8000 lekë. Nëse mallrat dhe/ose shërbimet e interesit tuaj përfshihen në më shumë se një klasë të klasifikimit të Nicës, atëherë për çdo klasë shtesë ju duhet të paguani edhe 2500 lekë. | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | e internetit te e-albania. Se fundmi, kerkoja te informohesha, nese mundem, nese tarifat e parashikuara ne e-albania, jane tarifa te vlefshme per te gjithe 10 vjeçarin e vlefshmerise dhe perdorimit te Markes Tregtare, apo eshte pagese vjetore? Jam ne pritje te pergjigjes suaj. Faleminderit paraprakisht! | | Regjistrimi i një marke bëhet për 10 vjet, duke filluar nga data e depozitimit dhe mund të ripërtërihet pafundësisht për periudha dhjetëvjeçare.<br><br>Në lidhje me tarifat bashkëngjitur gjeni:<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale".<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 61 | 01/02/2024 | 1.Aplikimi mund te behet nga cfare person i autorizuar icili disponon nje nenshkrim elektronik apo vetem nga persona te cilet gjendet Regjistri Personave te Autorizuar | 01/02/2024 | 1.Personat që kanë vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, ose që kryejnë veprimtari brenda territorit të saj, mund të përfaqësohen në DPPI vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tjerë, që nuk janë të regjistruar në këtë drejtori, por drejtojnë ose janë të punësuar te ky person dhe janë të | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. Tek vendosja e klases, pasi vendoset numri i klases perkatese duhet te percakohet sakte cdo nenkategori sipas peshkrimit qe gjenden tek ajo klase apo sipas peshrimit qe ben vet aplikanti. | | pajisur me autorizim përfaqësimi.<br>Subjektet e huaja mund të aplikojnë për regjistrimin e markës së tyre vetëm nëpërmjet një përfaqësuesi te autorizuar, të licencuar në DPPI, të pajisur me autorizim përfaqësimi ose prokurë, sipas parashikimeve të Kodit Civil.<br><br>2. Në lidhje me plotësimin e klasave për mallrat/shërbimet që kërkohet të regjistrohet marka, ky plotësim kryhet në gjuhën shqipe, i përkthyer në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Nicës. | | |
| 62 | 16/02/2024 | Për të siguruar një hapësirë të përshtatshme për biznesin tim, do isha mirënjohës nëse mund të merrja një listë të markave apo llojeve të bizneseve që nuk janë lejuar të operojnë në Shqipëri, dhe arsyetimi për këtë kufizim. Ky informacion do të ndihmonte në planifikimin dhe vlerësimin e mundësive të një biznesi të ri në këtë treg. | 20/02/2024 | Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë se DPPI jep informacion vetëm për marka të aplikuara për regjistrim dhe/ose të regjistruara<br>përmes kërkesës "Aplikim për hetim për objektet e pronësisë industriale".<br>Për më shumë informacion bashkëngjitur gjeni ligjin nr.9947, datë 7.7.2008 “PËR PRONËSINË INDUSTRIALE”, i ndryshuar. | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ju falenderoj paraprakisht për kohën dhe informacionin që do të mundeni të më siguroni. Pres me interes përgjigjen tuaj.<br>Me respekt, | | | | |
| 63 | 17/02/2024 | Do doja te kryeja rregjistrimin e emrit dhe te logos te disa apartamenteve qe ne menaxhojme per qera ditore,dhe agjensia juaj merej me rregjistrimin e tyre. Ju lutem doja te dija se cila eshte rruga dhe dokumentacioni qe une ta ndjek qe te mundur rregjistrimin. | 20/02/2024 | Në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës ju informojmë se:<br>Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br>Bashkëngjitur gjeni:<br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, procedurën e regjistrimit të tyre.<br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 64 | 22/02/2024 | Jam i interesuar per te markuar emrin dhe logon e biznesit tim. Aktualisht dua te hap nje person fizik. Doja tju pyesja nese me mbrapa kaloj ne person juridik, a mund ta transferoj marken? | 23/02/2024 | Në vijim të emailit tuaj ju informojmë se në lidhje me transferimin e pronësisë ju duhet të konsultoheni me nenin 162 të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar, nenin 33 të VKM nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat", Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te- | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | autorizuar/ .<br><br>Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Ligjin nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar,<br>-VKM nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat". | | |
| 65 | 21/02/2024 | Dua te bej rregjistrimin e nje programi kompjuteri (si patente apo marke) dhe logon. Te programi perfshihet dhe domani.<br>Mund te me tregoni dokumentacionin qe duhet per kete procedure + formularet perkates dhe tarifat qe duhet te paguaj. | 23/02/2024 | 1. Në bazë të nenit 189, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni publik që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së, të cilat janë markat tregtare, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, disenjot industriale, patentat dhe modelet e përdorimit, topografitë e qarqeve të integruara, varietetet bimore.<br><br>2. Në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës ju informojmë se:<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | -Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngji-tur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, proc edurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ .<br><br>3. Referuar Ligjit Nr. 35/2016 "Për të drejtat e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura m to", **programet kompjuterike**, janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit. Për sa më sipër, ju lutemi drejtohuni Drejtorisë për të Drejtat e Autorit.<br><br>4. Referuar rregullores nr. 02 datë 21.02.2008 PER " Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al", autoriteti përgjegjës" për regjistrimin dhe administrimin e emrave të **domain-eve** është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Për sa më sipër, ju lutemi drejtohuni AKEP. | | |
| 66 | 07/03/2024 | Me duhet te bej regjistrimin e nje brandi kryesor dhe nje logo qe do perdoret per veshje sportive.<br><br>Do me duhet nje informacion, lidhur me menyren e regjistrimit, nese duhet ta bej si nipt apo si individ. | 08/03/2024 | Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë në lidhje me procedurën për regjistrimin kombëtar të markës, si më poshtë :<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkat | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, “Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik” të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>**-Plotësimi i** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues. Aplikanti mund të jetë vetëm një, ose individ, ose subjekt tregtar.**<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngji-tur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, proc edurën e regjistrimit të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 67 | 07/03/2024 | Interesohem per | 08/03/2024 | Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë në lidhje me | E-mail | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | regjistrimin e dy markave, konkretisht emrin dhe logo. Kam gjetur disa informacione sipas legjislacionit perkates dhe website tuaj por do të doja udhëzime të mëtejshme në lidhje me procedurat që duhet të ndjekim dhe tarifat përkatëse. | | procedurën për regjistrimin kombëtar të markës, si më poshtë :<br><br>• Prej datës 01.05.2022, aplikimet kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania (edhe aty gjendet informacion për kryerjen e aplikimeve), përkatësisht në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=205&service_type=Y .<br><br>• Aplikimi mund të kryhet nga aplikanti ose nga përfaqësuesi i tij me autorizim. Autorizimi i përfaqësimit (original) dërgohet në rrugë postare, bazuar në Vendimin numër 4, datë 20.06.2022, "Për caktimin e kushteve, afateve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik" të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).<br><br>• Dokumentacioni i kërkuar për kryerjen e aplikimit:<br><br>-Plotësimi i formularit të aplikimit me të dhënat kryesore për subjektin aplikues.<br><br>-Dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës. Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.<br><br>• Bashkëngjitur gjeni:<br><br>-Broshurë që ju informon në mënyrë të detajuar në lidhje me markat, aplikimin për regjistrim, proc | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | edurën<br>e regjistrimit<br>të tyre.<br><br>-Faturën për arkëtim që duhet të paraqitni në momentin<br>e pagesës, e cila kryhet vetëm në BKT.<br><br>-Vendimin nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave<br>për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.<br><br>-VKM Nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat".<br><br>-Ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | | |
| 67 | 13/03/2024 | Ju lutem kam nevoje per informacion lidhur me procesin e regjistrimit nderkombetar te nje marke. Duhet si fillim te jete bere regjistrimi kombetar pastaj te behet regjistrimi nderkombetar? Gjithashtu, per regjistrimin kombetar per here te pare, cila eshte procedura per te hetuar nese nje marke eshte e zene? | 20/03/2024 | Në vijim të emailit tuaj ju informojmë se:<br><br>Çdo aplikim kryhet përmes portalit e-Albania.<br>Ju mund të kryeni hetim pa pagesë në faqen zyrtare të DPPI dppi.gov.al, ose mund të aplikoni përmes portalit e-Albania kërkesën "Aplikim për hetim të objekteve të pronësisë industriale", kundrejt pagesës në vlerën 1000 lekë për hetim.<br>Në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar të markës, gjeni bashkëngjitur broshurën shpieguese.<br><br>Gjithashtu, në rast nevoje ose paqartësie, ju mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar/ . | E-mail | 0 |